

## GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Rasti numër: P. 94/14

22 Maj 2014

### NE EMËR TË POPULLIT

Kryetari i trupit gjykues i Gjykatës Themelore në Prizren, Gjyqtari i EULEX-it Vladimir Mikula, i ndihmuar nga Sonila MacNeil si procesmbajtëse, në rastin penal kundër:

|                      |                                 |
|----------------------|---------------------------------|
| Emri                 | H.                              |
| Mbiemri              | I.(më herët T.)                 |
| Emri i babait        | I.T.                            |
| Emri i nënës         | Q.M.                            |
| Data e lindjes       | .....                           |
| Vendi i lindjes      | ....., .....                    |
| Gjinia               | ....                            |
| Adresa               | .....                           |
| Kombësia             | .....                           |
| Nënshtetësia         | .....                           |
| Nr. KI               | Pasaporta ....., Nr. I KI ..... |
| Profesioni           | .....                           |
| Gjendja<br>Ekonomike |                                 |
| Mesatare             |                                 |
| Shkollimi            | .....                           |

Statusi Familjar .....

Procedura të tjera .....  
penale në zhvillim:

Dënime të .....  
Mëparshme

Paraburgimi Në paraburgim që nga 5 Shkurti 2014. I arrestuar më 4 Shkurt, 2014  
në ora 13:50. Paraburgimi aktual përfundon më 4 Korrik 2014.

**AKUZZUAR** me Aktakuzën e Prokurorit të EULEX-it PPS Nr. 82/2011 me datë 23 Prill 2014 dhe e parashtruar me datë 25 Prill 2014, e modifikuar me datë 19 Maj 2014, për pikat e akuzës si në vijim:

**AKUZA 2:**

**Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike,** e kryer në bashkë-kryerje në kundërshtim me Nenin 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) në lidhje me Nenin 23<sup>1</sup>, dhe e dënueshme me një gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.

***Sepse***

Ndërmjet datës 01 Tetor 2009 dhe 25 Nëntorit 2009, H.I ka kryer veprën e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për shpërndarje dhe shitje në vendet e Evropës Perëndimore duke përfshirë Zvicrën, Holandë, Itali dhe/ose Gjermani, të një dërgese prej 109kg të kanabis sativa si anëtar i

---

<sup>1</sup> Që korrenpondon me Nenet 273 dhe 279 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 e vitit 2012 (kodi I ri)

një grupi, kanabisi është sekuestruar me datën 25 Nëntor 2009 nga një makinë e tipit Mercedes me targa TR 7598 I (Shqipëri) në fshatin Maminas, Durrës, në magjistralen Durrës-Tiranë, Republika e Shqipërisë, dhe e paketuar në 102 paketa.

### **AKUZA 3:**

**Krim i organizuar**, në kundërshtim me Nenin 274 paragrafi 2 i KPK-së<sup>2</sup>, e dënueshme më një gjobë deri në shumë prej 500.000 EUR dhe me burgim prej së paku 5 vjet.

### ***Sepse***

Ndërmjet datës 24 Korrik 2009 dhe 25 Nëntor 2009, H.I në territorin e Kosovës kryen veprën e krimit të organizuar duke kryer një vepër të rëndë penale, përkatësisht blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm nga Shqipëria në Kosovë dhe më tej në vendet në Evropën Perëndimore, *inter alia*, Slloveni, Itali, Gjermani, Zvicër dhe/apo Holandë, në një grup të strukturuar së bashku me Xh.Th, A.K, G.Gj, G.I, A.T, dhe bashkë-kryerës të tjerë të paidentifikuar; duke marrë pjesë në mënyrë aktive në grup; duke organizuar, krijuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e grupit; me qëllim të përfitimit, në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte, përfitim financiar apo përfitime tjera materiale.

**PAS** mbajtjes së seancës së parë fillestare, një seancë e mbyllur me datë 13 Maj 2014, dhe pastaj në seancë të hapur me datë 19 Maj 2014 në të cilën Prokurori i EULEX-it i zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) është tërhequr nga akuzat në pikën 1 dhe 4 të aktakuzës në fjalë,

---

<sup>2</sup>(Që korrespondon me Nenin 283 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 I vitit 2012 (kodi i ri).

**DUKE** pranuar Marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë PSRK PPS Nr: 82/2011 me datë 12 Maj 2014 parashtruar me datë 19 Maj 2014 nga PSRK-ja, në prani të të pandehurit H.I (më parë T.), avokatit të tij mbrojtës Ramë Gashi dhe në prani të Prokurorit të EULEX-it Martin Hackett,

**NË BAZË TË** Nenit 359 të Kodit të Procedurës Penale<sup>3</sup> (në tekstin e mëtejme “KPP”) këtë datë të 22 Majit 2014, në seancë të hapur dhe në prani të të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës dhe Prokurorit të EULEX-it, Gjykata lëshon dhe shpall si në vijim:

### **AKTGJYKIM**

Pikat 1 dhe 4 të aktakuzës kundër:

**H.I (më parë T.)**, me të dhëna personale si më lartë,

**AKUZA 1:** Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, e kryer në bashkë-kryerje në kundërshtim me Nenin 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) në lidhje me Nenin 23<sup>4</sup>, dhe e dënueshme me një gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.

### ***Sepse***

Ndërmjet datës 24 Korrik 2009 dhe 15 Shtatorit 2009, H.I e ka kryer veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për shpërndarje dhe shitje në vendet e Evropës Perëndimore duke përfshirë Zvicrën, të një dërgese të heroinës si pjesëtarë i një grupi.

---

<sup>3</sup>Ligji Nr. 04/L-123

<sup>4</sup> Që përputhet me Nenet 273 dhe 279 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 I vitit 2012 (kodi I ri)

**AKUZA 4: Pastrimi i parave**, në kundërshtim me Nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe Veprave të Ngjashme Penale dhe /ose në kundërshtim me Nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-196 mbi *Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit të datës 03/09/2010 i nxjerrë me datë 18/10/2010*)<sup>5</sup>, i dënueshëm me burgim deri në dhjetë vite dhe me një gjobë në vlerë deri në tre herë të vlerës së pronës e cila është objekt i veprës penale

### **Sepse**

Ndërmjet 24 Korrikut 2009 dhe 25 Nëntorit 2009, H.I në territorin e Kosovës dhe/ose jashtë vendit kryen veprën penale të Pastrimit të Parave me dashje apo duke pasur shkak për të ditur se prona e caktuar, gjegjësisht paratë e gatshme apo mjete tjera monetare, janë të ardhurat e veprimtarisë kriminale dhe e cila pronë në fakt buron nga veprat penale (Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike dhe krimi i organizuar):

Në bazë të Nenit 363 paragrafi 1 (1.1) i KPP-së janë **REFUZUAR** sepse Prokurori i PSRK-së është tërhequr nga akuzat në pikat 1 dhe 4 të aktakuzës në fjalë gjatë seancës së parë fillestare.

Më tej, sipas Nenit 365 të KPP-së,

**I pandehuri H.I (më parë T.)**, është shpallur **FAJTOR** në lidhje me **PIKËN 2**, të aktakuzës:

Për veprën penale të **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike**, e kryer në bashkë-kryerje në kundërshtim me Nenin 229, paragrafi 4 i KPK-së në lidhje me Nenin 23 dhe e dënueshme me një gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.

---

<sup>5</sup> Që korrespondon me Nenin 309 të Kodit Penal të Kosovës, Ligji 04/L-082 I vitit 2012 (kodi I ri)

## Sepse

Ndërmjet datës 1 Tetor 2009 dhe 25 Nëntor 2009, H.I e ka kryer veprën e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për shpërndarje dhe shitje në vendet e Evropës Perëndimore, përkatësisht Zvicër, Holandë, Itali dhe/apo Gjermani, të një dërgese me së paku 109 kg kanabis sativa si pjesëtar i një grupi, kanabisi i cili është sekuestruar nga Policia Shqiptare më 25 Nëntor 2009 nga një veturë Mercedes me targa TR 7598 I (Shqipëri) në fshatin Maminas, Durrës në magjistralen mes Durrësit dhe Tiranës, Republika e Shqipërisë që i paketuara në 102 paketime,

Dhe mbi **PIKËN 3** të aktakuzës:

Për veprën penale të **Krim i Organizuar** në kundërshtim me Nenin 274 paragrafi 2 i KPK-së, i dënueshëm me një gjobë deri në 500.000 EUR dhe me burgim prej së paku 5 vitesh.

## Sepse

Ndërmjet 24 Korrikut 2009 dhe 25 Nëntor 2009, H.I në territorin e Kosovës kryen veprën e krimit të organizuar duke kryer një vepër të rëndë penale, përkatësisht blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm nga Shqipëria në Kosovë dhe më tej në vendet në Evropën Perëndimore, inter alia, Slloveni, Itali, Gjermani, Zvicër dhe/apo Holandë, në një grup të strukturuar së bashku me Xh.Th, A.K, G.Gj, G.I, A.T, dhe bashkë-kryerës të tjerë të pidentifikuar; duke marrë pjesë në mënyrë aktive në grup; duke organizuar, krijuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e grupit; me qëllim të përfitimit, në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte ,të përfitimit financiar apo përfitimeve tjera materiale.

**NË KËTË MËNYRË**, në pajtim me Nenin 2 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës<sup>6</sup>, ka kryer veprën penale të Krimin të Organizuar, në kundërshtim me Nenin 274 paragrafi 2 i KPK-së në lidhje me veprën penale të Blerjes së paautorizuar, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike në bazë të Nenit 229 paragrafi 4 i KPK-së.

**DUKE QENË** i dënuar për veprën penale të Krimin të Organizuar sipas Nenit 274 paragrafi 2 i KPK-së, në lidhshmëri me veprën penale të Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike sipas Nenit 229 paragrafi 4 i KPK-së, në bazë të Neneve 3, 34,36, 38, 39, 64 , 65 dhe 274 (2) të KPK-së i pandehuri, **H.I (më parë T.)**, është dënuar me dënimin prej **4 (katër) vite dhe 6 (gjashtë) muaj burgim** dhe me një **gjobë në shumë prej 600 (gjashtë qind) Eurosh**, që të paguhet brenda 30 ditësh nga data kur aktgjykimi të marri formën e prerë.

Në bazë të Nenit 39, paragrafët 3 dhe 4 të KPK-së, poqese i pandehuri nuk dëshiron apo nuk është në gjendje që ta paguajë gjobën, gjykata mund të lejojë që gjoba të paguhet në kiste përgjatë një periudhe e cila nuk do i tejkalojë dy vjet. Pas kësaj, poqese personi i dënuar mbetet ende jo në gjendje për ta paguar gjobën, apo nuk dëshiron, gjykata mundet, me pajtimin e personit të dënuar, që ta zëvendësojë gjobën me një urdhër për të kryer punë në dobi të komunitetit e cila nuk do ndërhyjë me aktivitetet e tija ose të saja të rregullta të punësimit, aq sa do jetë e mundshme.

Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e gjobës me një urdhër për kryerjen e punëve në dobi të komunitetit, ashtu siq është dhënë në paragrafin 3 të Nenit në fjalë, gjykata do urdhërojë një ditë burgim për secilën shumë prej 15 eurosh të gjobës, me kusht që dënimi me burg nuk i tejkalon gjashtë muaj.

Koha e kaluar në paraburgim do të përfshihet në dënimin me burg.

---

<sup>6</sup> Kodi Penal I Kosovës REG e UNMIK-ut/2003/25

Shpenzimet e procedurës penale, nuk do të paguhen nga i pandehuri.

**MË TEJ**, paraburgimi pra është zgjatur në këtë mënyrë deri sa Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, për shkak se rreziku i arratisjes ende ekziston siç parashihet me Nenin 187, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.2.1 të KPP-së, por jo më shumë se skadimi i afatit të dënimit të shqiptuar në Aktgjykim. Një Aktvendim i veçantë në lidhje me paraburgimin do të lëshohet.

## **ARSYETIMI**

### **I. Sfondi procedural**

Më 24 Tetor 2011, Prokurori i EULEX-it Maarit Loimukoski lëshoi një Aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit.

Aktvendimi mbi fillimin e hetimeve është parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë (e quajtur më parë Gjykata e Qarkut) më 24 Tetor 2011. Më 2 Nëntor 2011, Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore të Prishtinës ka vendosur se Gjykata Themelore e Prishtinës nuk kishte juridiksion territorial mbi rastin, me Gjykatën Themelore në Prizrenit (e quajtur më parë Gjykata e Qarkut) duke qenë kompetente për rastin. Prandaj, Prokurori e ka ri-parashtruar aktvendimin mbi fillimin e hetimeve me Gjykatën Themelore në Prizren për gjykim me datë 16 Nëntor 2011.

Me datë 24 Prill 2012, Gjyqtari i procedurës paraprake e ka aprovuar vazhdimin e hetimeve për një periudhë prej gjashtë muajsh. Gjer me datë 24 Tetor 2012.



Pas kësaj, Gjyqtari i procedurës paraprake e ka aprovuar vazhdimin e hetimeve edhe për gjashtë muaj deri me datë 24 Prill 2013. Sipas Nenit 159, paragrafi 1 i KPK-së, një hetim skadon pasi kanë kaluar dy (2) vite që kur është iniciuar. Si i tillë, ky hetim ka vazhduar sipas ligjit.

Me datë 29 Nëntor 2013, Gjyqtari i procedurës paraprake e ka aprovuar vazhdimin e hetimeve për një periudhe prej gjashte muajsh deri me datë 24 Prill 2014.

Me 29 Nëntor 2013, Gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it e ka lëshuar një Urdhër Arrest kundër të pandehurit.

Më 29 Nëntor 2013, Gjyqtari i procedurës paraprake i EULEX-it ka lëshuar një fletë-rreshtim kombëtar për të pandehurin dhe një kërkesë për autoritetet përkatëse për lëshimin e një fletë-rreshtimi ndërkombëtar e cila qe lëshuar me kohë.

Me datë 14 Nëntor, Prokurori i atëhershëm ka lëshuar një Aktvendim mbi pezullimin e hetimeve sipas Nenit 157, par 1 i KPK-së.

Me 4 Shkurt 2014, i pandehuri H.T ka hyrë në Kosovë. Prokurori ka lëshuar një Aktvendim për ti Ri-Hapur hetimet.

Me 4 Shkurt 2014, i pandehuri H.T qe arrestuar në Kosovë.

Me 5 Shkurt 2014, Gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin e të pandehurit. Që atëherë paraburgimi kundër të pandehurit H.I ( më parë T.) qe vazhduar.

Me 25 Prill 2014PSRK-ja ka ngritur një aktakuzë kundër të pandehurit H.I (më parë T.) PPS No. 82/2011 me datë 23 Prill 2014.

Shqyrtimi fillestar ka filluar me datë 13 Maj 2014 në Gjykatën Themelore në Prizren. Atë ditë avokati mbrojtës i të pandehurit e ka informuar gjykatën në lidhje me diskutimet mes palëve në lidhje me një marrëveshje të mundshme të fajësisë. Sipas kërkesës së palëve kryetari i trupit gjykues e ka shtyrë shqyrtimin fillestar në mënyrë që ato diskutime të vazhdojnë. Me datë 19

Maj 2014 prokurori ka parashtruar në gjykatë marrëveshjen e fajësisë të nënshkruar nga të dyja palët.

Në marrëveshjen për pranimin e fajësisë në fjalë, Pika 3 e akuzës që ndryshuar për ta akuzuar të pandehurin vetëm nën Nenin 274, paragrafi 2.

Gjatë seancës mbi pranimin e fajësisë, me datë 19 Maj 2014, Prokurori u tërhoq nga Pika 1 dhe 4 e aktakuzës.

## **II. Kompetencat**

Gjyqtari është kompetent për të gjykuar këtë rast sipas Neneve 20, 21, 22, 25, 26 dhe 29 të KPP-së dhe Ligjit mbi Gjykatat, Ligji nr.03/L-199.

KPP-ja që ka hyrë në fuqi me datë 1 Janar 2013 i ka ri-klasifikuar Gjykatat e Qarkut si Gjykata Themelore.

Krimet e pretenduara qenë kryer në Kosovë dhe gjetiu, andaj kompetenca për ti gjykuar këto krime bie në juridiksion të Gjykatës Themelore në Prizren. Prandaj, kjo Gjykatë ka juridiksion territorial mbi çështjen në bazë të Nenit 29 të KPP-së.

PSRK-ja ka kompetencë ekskluzive mbi veprën e Krimin të Organizuar, në përputhje me Nenin 5.1 n) të ligjit mbi PSRK-në, Ligji 03/L-052 i vitit 2008.

Neni 3.2 i Ligjit nr.03/L-053 për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë thotë që gjyqtarët e EULEX-it do të kenë juridiksion mbi rastet e ndjekura penalisht nga PSRK-ja. Si pasojë, gjykatësi i EULEX-it ka juridiksion në këtë rast.

## **III. Aktakuza**

I pandehuri qe akuzuar **në katër pika** të Aktakuzës.

Nën **Pikën 1** (Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike) qe pretenduar se:

Ndërmjet datës 24 Korrik 2009 dhe 15 Shtatorit 2009, H.I ka kryer veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për shpërndarje dhe shitje në vendet e Evropës Perëndimore duke përfshirë Zvicrën të një dërgese të heroinës si pjesëtarë i një grupi.

Nën **Pikën 2** (Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike) qe pretenduar se:

Ndërmjet datës 01 Tetor 2009 dhe 25 Nëntorit 2009, H.I ka kryer veprën e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për shpërndarje dhe shitje në vendet e Evropës Perëndimore duke përfshirë Zvicrën, Holandë, Itali dhe/ose Gjermani, të një dërgese prej 109kg të kanabis sativa si anëtar i një grupi, kanabisi është sekuestruar me datën 25 Nëntor 2009 nga një makinë e tipit Mercedes me targa TR 7598 I (Shqipëri) në fshatin Maminas, Durrës, në magjistralen Durrës-Tiranë, Republika e Shqipërisë, dhe e paketuar në 102 paketa.

Nën **Pikën 3** (Krim i Organizuar) qe pretenduar se:

Ndërmjet datës 24 Korrik 2009 dhe 25 Nëntor 2009, H.I në territorin e Kosovës kryen veprën e krimit të organizuar duke kryer një vepër të rëndë penale, përkatësisht blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm nga Shqipëria në Kosovë dhe më tej në vendet në Evropën Perëndimore, *inter alia*, Slloveni, Itali, Gjermani, Zvicër dhe/apo Holandë, në një grup të strukturuar së bashku me Xh.Th, A.K, G.Gj, G.I, A.T, dhe

bashkë-kryerës të tjerë të pidentifikuar; duke marrë pjesë në mënyrë aktive në grup; duke organizuar, krijuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e grupit; me qëllim të përfitimit, në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte, përfitim financiar apo përfitime tjera materiale.

Nën **Pikën 4** (Pastrim i Parave) që pretenduar se:

Ndërmjet 24 Korrikut 2009 dhe 25 Nëntorit 2009, H.I në territorin e Kosovës dhe/ose jashtë vendit kryen veprën penale të Pastrimit të Parave me dashje apo duke pasur shkak për të ditur se prona e caktuar, gjegjësisht paratë e gatshme apo mjete tjera monetare, janë të ardhurat e veprimtarisë kriminale dhe e cila pronë në fakt buron nga veprat penale (Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike dhe krimi i organizuar):

- (i) konvertimi ose transferimi, apo përpjekja të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes së natyrës, burimit, vendndodhjes, disponimit, lëvizjes ose pronësisë së pronës;
- (ii) konvertimi ose transferimi, apo përpjekja të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit – domethënë, Xh.Th, Q.Th, A.K, G.Gj dhe S.T dhe anëtarëve të tjerë të pidentifikuar të grupit kriminal – të cilët janë të përfshirë në kryerjen e veprave penale që prodhuan pronën për t'iu shmangur pasojave ligjore;
- (iii) konvertimi ose transferimi, apo përpjekja të konvertojë apo transferojë, pasurinë me qëllim tënxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal (blerja, shitja dhe shpërndarja e narkotikëve); dhe/ose
- (iv) marrjen, zotërimin ose përdorimin e pronës (para të gatshme apo mjete të tjera monetare).

#### **IV. Konsideratat lidhur me provat**

##### **Barra dhe standardi i provës**

Neni 6 (2) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm të “KEDN”),

Kushtetuta e Kosovës dhe Neni 3 (1) i KPP-së, parashikojë prezumimin e pafajësisë për të cilën të Akuzuarit kanë të drejtë. Ky prezumim e vë barrën mbi prokurorinë për të përcaktuar fajin e të akuzuarit, një barrë e cila mbetet mbi prokurorinë përgjatë gjithë gjykimit.

Neni 370 (7) i KPP-së përcakton se *"gjykata duhet të theksojë në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për këtë"*. Prandaj, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë në lidhje me secilën nga akuzat e ngritura kundër secilit prej të Akuzuarve, nëse ajo është e kënaqur mbi bazën e të gjitha provave në mënyrë që të jetë e sigurtë se çdo element i atij krimi është përcaktuar. Çdo dyshim duhet të zgjidhet në favor të të akuzuarit.

Gjykata, në bazë të Nenit 7 (1), (2) të KPP-së *'...duhet që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm "dhe '...ka për detyrë të shqyrtojnë me kujdes dhe me përkushtim maksimal profesional dhe për të krijuar me vëmendje të barabartë faktet kundër të pandehurit, si dhe ata që janë në favor'*.

Dëshmitë kundër H.It përbëhen kryesisht nga përgjimet e ligjshme të telekomunikacionit në mes të të akuzuarit dhe bashkëpunëtorëve të tij kriminale dhe në mes vetë bashkëpunëtorëve kriminal. Këto dëshmi mbështeten nga vëzhgime fotografike dhe me video në vende publike; informacion i marrë nga policia e huaj dhe autoritetet prokuroriale përmes ndihmës formale ligjore ndërkombëtare, në rradhë të parë Shqipëri, duke përfshirë raportet mjeko-ligjore; dhe provat e marra gjatë bastisjeve të kryera nga Policia e Kosovës të objekteve të Xh.Tht dhe A.K që i janë nënshtruar analizës së ekspertëve.

## **V. Marrëveshja mbi fajësinë**

Mundësia e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë që paraqitur në Gjykatë në mëngjesin e datës 13 Maj 2014 gjatë seancës së parë fillestare në Gjykatën Themelore në Prizren.

Në këto rrethana, Gjykata e shtyu seancën deri me datë 19 Maj 2014 për të siguruar që të gjitha palët të kishin kohë për të u informuar plotësisht për të drejtat dhe obligimet e tyre dhe në mënyrë që çdo njëra prej kushteve, precedent e marrëveshjes, të mund të përfundojë në mënyrë të pranueshme nga të gjitha palët.

Me datë 19 Maj 2014 PSRK-ja ka paraqitur në gjykatë një marrëveshje me shkrim mbi pranimin e fajësisë PSRK PPS No: 82/2011 e datës 12 Maj 2014, në të cilën qe dakorduar që i pandehuri do ta pranojë fajësinë nën Pikën 2 dhe 3 të aktakuzës, si në vijim:

### **AKUZA 2:**

**Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike**, e kryer në bashkë-kryerje në kundërshtim me Nenin 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) në lidhje me Nenin 23, dhe e dënueshme me një gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Ndërmjet datës 01 Tetor 2009 dhe 25 Nëntorit 2009, H.I ka kryer veprën e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për shpërndarje dhe shitje në vendet e Evropës Perëndimore duke përfshirë Zvicrën, Holandë, Itali dhe/ose Gjermani, të një dërgese prej 109kg të kanabis sativa si anëtar i një grupi, kanabisi është sekuestruar me datën 25 Nëntor 2009 nga një makinë e tipit Mercedes me targa TR 7598 I (Shqipëri) në fshatin Maminas, Durrës, në magjistralen Durrës-Tiranë, Republika e Shqipërisë, dhe i paketuar në 102 paketa.

### **AKUZA 3:**

**Krim i organizuar**, në kundërshtim me Nenin 274 paragrafi 2 i KPK-së, e dënueshme më një gjobë deri në shumë prej 500.000 EUR dhe me burgim prej së paku 5 vjet.

Ndërmjet datës 24 Korrik 2009 dhe 25 Nëntor 2009, H.I në territorin e Kosovës kryen veprën e krimit të organizuar duke kryer një vepër të rëndë penale, përkatësisht blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm nga Shqipëria në Kosovë dhe më tej në vendet në Evropën Perëndimore, *inter alia*, Slloveni, Itali, Gjermani, Zvicër dhe/apo Holandë, në një grup të strukturuar së bashku me Xh.Th, A.K, G.Gj, G.I, A.T, dhe bashkë-kryerës të tjerë të paidentifikuar; duke marrë pjesë në mënyrë aktive në grup; duke organizuar, krijuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e grupit; me qëllim të përfitimit, në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte, të përfitimit financiar apo përfitimeve tjera materiale.

Pika 3 është ndryshuar për të akuzuar të pandehurin vetëm në bazë të Nenit 274 paragrafi 2.

Gjatë shqyrtimit mbi pranimin e fajësisë me datë 19 Maj 2014, Prokurori është tërhequr nga **PIKA1** dhe 4 e aktakuzës.

Në bazë të Nenit 233 paragrafi 18 i KPP-së, në shqyrtimin se a duhet pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata mori në pyetje të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe prokurorin, dhe ka konstatuar se a) i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, b) Pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin dhe i akuzuari nuk ka qenë i detyruar të deklarojë fajësinë ose i shtrënguar në ndonjë mënyrë, c) Pranimi i fajësisë mbështetet nga faktet dhe provat materiale të rastit që janë të përfshira në aktakuzë dhe d) asnjë nga rrethanat e parapara në Nenin 253, paragrafët 1 dhe 2 të KPP nuk ekzistojnë.

Duke qenë i bindur se të gjitha kushtet në paragrafin 18 të Nenit 233 janë përcaktuar, Gjykata pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe urdhëroi që marrëveshja të i dorëzohet gjykatës.

## **VI. Përgjegjësia e të pandehurit**

I pandehuri H.I (më parë T.) ishte akuzuar me katër akuza në Aktakuzë.

Në Pikën 1 ai qe akuzuar me: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, e kryer në bashkë-kryerje në kundërshtim me Nenin 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) në lidhshmëri me Nenin 23.

Në Pikën 2 ai qe akuzuar me: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, e kryer në bashkë-kryerje në kundërshtim me Nenin 229, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) në lidhshmëri me Nenin 23.

Në Pikën 3 ai qe akuzuar me Krim të Organizuar, në kundërshtim me Nenin 274 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK-së.

Në Pikën 4 ai qe akuzuar me Pastrim të Parave, Në kundërshtim me Nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 mbi Pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale dhe / ose në shkelje të Nenit 32 të Ligjit 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit e 2010/9/3, i shpallur më 18.10.2010).

Në marrëveshjen e fajësisë të datës 12 Maj 2014, të nënshkruar nga palët, qe theksuar “baza faktike për këtë marrëveshje të fajësisë është paraqitur në aktakuzë si fakte që kanë të bëjnë me Pikën 2 (dërgesa e Nëntorit) dhe Pika 3 (Krimin të Organizuar).

Gjykata pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e cila është mbështetur nga provat dhe ka refuzuar Pikën 1 dhe 4 të aktakuzës.

Prandaj, Gjykata konstatoi se i pandehuri H.I (më parë T.) e ka kryer veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, kryer në bashkëkryerje në kundërshtim me Nenin 229 paragrafi 4 i KPK-së, lidhur me Nenin 23 të saj, që dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet.



Së ndërmjet datës 01 Tetor 2009 dhe 25 Nëntorit 2009, H.I e ka kryer veprën e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike duke marrë pjesë në eksportimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës për shpërndarje dhe shitje në vendet e Evropës Perëndimore duke përfshirë Zvicrën, Holandë, Itali dhe/ose Gjermani, të një dërgese prej 109kg të kanabis sativa si anëtar i një grupi, kanabisi është sekuestruar me datën 25 Nëntor 2009 nga një makinë e tipit Mercedes me targa TR 7598 I (Shqipëri) në fshatin Maminas, Durrës, në magjistralen Durrës-Tiranë, Republika e Shqipërisë, dhe e paketuar në 102 paketa,

Dhe veprën penale të Krimin të Organizuar në kundërshtim me Nenin 274 paragrafi 2 i KPK-së, e dënueshme me gjobë deri në 500.000 EUR dhe burgim prej së paku 5 vitesh.

Se ndërmjet datës 24 Korrik 2009 dhe 25 Nëntor 2009, H.I në territorin e Kosovës kryen veprën e krimin të organizuar duke kryer një vepër të rëndë penale, përkatësisht blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm nga Shqipëria në Kosovë dhe më tej në vendet në Evropën Perëndimore, inter alia, Slloveni, Itali, Gjermani, Zvicër dhe/apo Holandë, në një grup të strukturuar së bashku me Xh.Th, A.K, G.Gj, G.I, A.T, dhe bashkë-kryerës të tjerë të paidentifikuar; duke marrë pjesë në mënyrë aktive në grup; duke organizuar, krijuar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e grupit; me qëllim të përfitimit, në mënyrë të drejtpërdrejt apo indirekte, përfitim financiar apo përfitime tjera materiale.

## **VII. Dënimi**

Duke qenë i dënuar për veprën penale të Krimin të Organizuar nga Neni 274 paragrafi 2 i KPK-së në lidhje me veprën penale të Blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga Neni 229 paragrafi 4 i KPK-së, Gjykata konstatoi se Neni 274 paragrafi 2 i KPK-së i ' kodit të vjetër' është më i favorshëm për të pandehurin.

I akuzuari është 39 vjeç dhe i martuar, me katër fëmijë. Ai i përshkroi të ardhurat e tija si "mesatare".

Trupi Gjykues ka konstatuar se dënimi prej 4 (katër) vitesh dhe 6 (gjashtë) muaj burgim, si dhe gjoba në shumën prej 600 (gjashtëqind) Eurosh, është i arsyeshëm dhe proporcional.

Gjykata konstaton se dispozitat e Nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale janë përmbushur dhe se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është lidhur vullnetarisht nga i akuzuari dhe se ai e ka kuptuar rëndësinë e saj dhe implikimet e saja në lidhje me sjelljen e tij të ardhshme në kohën që ajo ishte nënshkruar nga ai. Gjykata vë në dukje se kopjet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë janë mbajtur nga palët dhe se një kopje është mbajtur në dosjen e Gjykatës.

Palët u tërhoqën nga të drejtat për të apeluar vendimin në fjalë.

Për arsyet e cekura në këtë dokument Gjykata e lëshon këtë Aktgjykimin.

---

**Gjyqtari Vladimir Mikula**  
**Kryetar i trupit gjykues**

---

**Sonila MacNeil**  
**Procesmbajtëse**